

Republika e Maqedonisë së Veriut

AGJENCIA TEKNIKE-OPERATIVE SHKUP

**RAPORT VJETOR
PËR PUNËN E AGJENCISË TEKNIKE-OPERATIVE SHKUP PËR VITIN 2019**

Shkup,

janar, 2020

Në bazë të nenit 7 të Ligjit për Agjencinë Teknike-Operative (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 71/18 dhe “Gazeta zyrtare e Maqedonisë së Veriut” nr. 98/19 – më tutje në tekstin: ATO), drejtori i Agjencisë Teknike-Operative Shkup (në tekstin e mëtutjeshëm – ATO), e miratoi

RAPORTIN VJETOR

PËR PUNËN E AGJENCISË TEKNIKE-OPERATIVE SHKUP PËR VITIN 2019

I. HYRJE

Agjencia Teknike-Operative është organ i mëvetësishëm dhe i pavarur shtetëror, i themeluar me Ligjin për Agjencinë Teknike-Operative (“Gazeta zyrtare e RM-së nr. 71/2018 nga 19.04.2018), me të cilin krahas themelimit të ATO-s, rregullohen edhe kompetencat, udhëheqja, të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës së punëtorëve në ATO, mbikëqyrja profesionale dhe financimi i ATO-s. Në vitin 2019 u miratua Ligji për ndryshimin e ligjit për Agjencinë Teknike-Operative (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 98/19 nga 21.05.2019).

II. NUMRI I KOMUNIKIMEVE TË AKTIVIZUARA PËR NEVOJAT E ORGANEVE TË AUTORIZUARA

Gjatë vitit 2019, ATO ndërmjetësoi teknikisht në aktivizimin e masës për ndjekje të komunikimeve në gjithsej pesëqind e njëzet e dy (522) komunikime për nevojat e organeve të autorizuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

III. NUMRI I KOMUNIKIMEVE TË AKTIVIZUARA PËR ÇDO ORGAN TË AUTORIZUAR VEÇMAS

Nga numri i cekur total i komunikimeve të aktivizuara për aktivizimin e të cilave ATO ka ndërmjetësuar teknikisht në vitin 2019:

- Dyqind e gjashtëdhjetë e nënë (269) komunikime u ndoqën teknikisht nga ATO për nevojat e BSP së MPB; dhe
- Tetë (8) komunikime u ndoqën teknikisht nga ATO për nevojat e Drejtorisë së Policisë Financiare të Ministrisë së Financave.

IV. GJENDJA DHE GJETJET E KONSTATUATA GJATË MBIKËQYRJEVE TË KRYERA PROFESIONALE NGA ATO MBI PUNËN E OPERATORËVE

Në kuadër të kompetencave të tyre ligjore ATO kryen mbikëqyrje profesionale të punës së operatorëve gjatë zbatimit të masave për ndjekje të komunikimeve. Gjatë vitit 2019, u bënë përgatitje, u krijuar të gjitha kushtet e domosdoshme dhe u krye mbikëqyrje profesionale mbi punën e operatorëve.

Nga radhët e punëtorëve në ATO u formua Komision për Mbikëqyrje Profesionale të përbërë nga kryetari dhe dy anëtarë me zëvendës të tyre të cilët i kryen mbikëqyrjet në operatorët gjatë vitit 2019.

Në ATO u përgatitën, u miratuan dhe u publikuan akte dhe dokumente të domosdoshme të publikuara të cilat i rregullojnë masat, standardet dhe procedurat për kryerje të mbikëqyrjes profesionale dhe atë.

- Rregullore për mënyrën e veprimit të operatorëve gjatë zbatimit të masave për ndjeke të komunikimeve dhe mënyrën e kryerjes së mbikëqyrjes profesionale nga Ato (“Gazeta zyrtare e republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 182/2019 nga 03.09.2019”), dhe
- Rregullore për masat dhe standardet e sigurisë së informatave të cilat janë të detyruar t’i zbatojnë operatorët e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike publike dhe/ose shërbime në lidhje me detyrimet për zbatim të masave për ndjekje të komunikimeve.
- “Lista e kontrolleve” përmes së cilës konstatohet plotësia e të gjitha aspekteve të sigurisë së infrastrukturës dhe mjedisit të sigurisë te operatorët.

Në fazë përgatitore të përpunimit të këtyre akteve dhe dokumenteve, ATO i përfshin subjektet relevante të cilat janë objekt i mbikëqyrjes profesionale për shkak të sensibilizimit dhe qëndrimit proaktiv, me qëllim të vendosjes së sistemit efikas për ndjekje të komunikimeve dhe kontrollit dhe mbikëqyrjes së tij. Gjithashtu, para miratimit dhe publikimit në “Gazetën zyrtare të RMV-së Rregullorja u vu në diskutim publik dhe ishte i hapur për sugjerime nga ekspertët.

Pas miratimit të akteve dhe dokumenteve të cekura, Komisioni i ATO në tremujorin e fundit 2019 realizoi gjithsej 4 (katër) mbikëqyrje, përkatësisht pas 2 (dy) mbikëqyrjeve profesionale të të dyja operatorët më të mëdhenj në Republikën e Maqedonisë së Veriut përkatësisht të Telekomit Maqedonas SHA Shkup dhe A1 Maqedonia, ndërsa u realizuan edhe takime përgatitore pune me operatorë tjerë të rrjeteve të komunikimeve elektronike publike në Republikën e Maqedonisë së Veriut për shkak të përcaktimit të statusit të gjendjeve në aspekt të detyrimeve për zbatim të masave për ndjekje të komunikimeve.

Konstatimet nga mbikëqyrjet profesionale i mundësuan ATO ta konstatojë plotësinë e kushteve të domosdoshme teknike mbi përdorimin e pajisjes teknike dhe përçuesve të komunikimeve elektronike për mundësimin e ndjekjes së komunikimeve, vendosjen e autoriteteve në pajtim me dokumentet e miratuara, por edhe shumë e rëndësishme për punën në këto teknologji dinamike në telekomunikimet, futja e serviseve të reja dhe mundësitë të vetë operatorët të cilët ATO duhet doemos t’i ndjekë për shkak të mundësimin të kalimit të papenguar teknik ndërmjet operatorit dhe organeve të autorizuar. Në kuadër të konstatimeve janë dhënë edhe afate për përmbushje të plotë të kushteve dhe/ose për harmonizim të procedurave.

Nga mbikëqyrjet e realizuara profesionale mbi operatorët dolën Raportet/Procesverbalet nga mbikëqyrja e kryer profesionale nga Komisioni i ATO për kryerje të mbikëqyrjes profesionale mbi operatorët, të cilët iu dorëzuan:

- Komisionit për Mbikëqyrje të Zbatimit të Masave për Ndjekje të Komunikimeve të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe
- Agjencisë për Komunikime Elektronike në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

V. NUMRI I PROCEDURAVE TË KRYERA DISIPLINORE PËR PUNËTORË NË ATO

Gjatë vitit 2019 në ATO u ngritën 2 (dy) procedura disiplinore për punëtorët e ATO.

VI. PUNA FINANCIARE E ATO

Në vitin 2019 me Buxhetin e Republikës së Maqedonisë ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 238/2018) u siguruan gjithsej mjete në shumë prej 108.830.000,00 (njëqindtetetë milionë e tetëqindtridhjetë mijë denarë) nga të cilat u realizuan gjithsej 80.195.760,00 (tetëdhjetë milionë e njëqindenëntëdhjetepesë mijë e shtatëqindgjashtëdhjetë denarë). Me ndryshimin dhe plotësimin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë 211/2019), u siguruan gjithsej 115.000.000,00 (njëqindpesëmbëdhjetë milionë denarë), nga të cilat u realizuan gjithsej 60.137.347,00 (gjashtëdhjetë milionë e njëqindtridhjeteshtatë mijë e treqindedyzeteshtatë denarë) dhe atë në shumat sipas zërave në vijim:

- Gjithsej 24.221.608,00 denarë janë realizuar në zërin 401 dhe 402;
- Gjithsej 568.794,00 denarë janë realizuar në zërin 420;
- Gjithsej 892.937,00 denarë janë realizuar në zërin 421;
- Gjithsej 570,.777,00 denarë janë realizuar në zërin 423;
- Gjithsej 18.363.442,00 denarë janë realizuar në zërin 424
- Gjithsej 16.424.953,00 denarë janë realizuar në zërin 425;
- Gjithsej 629.768,00 denarë janë realizuar në zërin 426;
- Gjithsej 17.392.143,00 denarë janë realizuar në zërin 480;
- Gjithsej 232.460,00 denarë janë realizuar në zërin 483, dhe
- Gjithsej 61.036.225,00 denarë janë realizuar në zërin 485.

Ky Raport vjetor për punën e ATO për vitin 2019 i dorëzohet për shqyrtim Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, më së voni deri në fund të shkurtit 2020 dhe publikohet në vend të dukshëm në faqen e internetit të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë Veriut.

AGJENCIA TEKNIKE-OPERATIVE SHKUP

DREJTOR

Zoran Angellovski
